



DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të SOS Fshatrave të Fëmijëve Shqipëri si dhe punonjësve të përkohshëm, vullnetarëve dhe palëve të tjera të cilët kanë akses në informacionin e Organizatës.

Qëllimi

Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës / kontraktues të cilët kanë akses në të dhënat personale të Organizatës. Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushë veprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacionet konfidenciale që njihen gjatë kryerjes së funksionit përkatës. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me punonjësin ka përfunduar.

Deklarata e konfidencialitetit

1. Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga Punëdhënësi ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit / kontraktimit si dhe pas përfundimit të tij.
2. Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.
3. Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbajë ato të sigurt, duke marrë të gjitha masat e përshtatëshme, në përputhje me pozicionin tim.
4. Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarte të larta profesionale në pozicionin tim

Punonjesi

Data

Drejtori Nacional